

kishim frikë se mos insullonim derën e madhe. Kur po bëheshim gati për të hikur Kapedani na porositi t' i bëjmë edhe një telegram nga Shkodra për arritjen t' onë me shënder.

Froku, një dial' i ri, fytyrë kuq, floke-verdhë, me sy të kalërit, dhe i shpejtë, u ngarkua prej Kapedanit të jetë kryetari i karvanit.

Me një seremoni të madhe e lamë shtëpin' e Kapedanit dhe ja muarm rëzës Malit Shenjt. Bukuria e këtij vëndi është e patreguarshme. Kalonim për mes pyjesh pe pishe, të cilat pisha munt të kenë patur diametria e trupit tyre pothuaj no një metro; munt edhe të qënkeshin pesëmbëdhjetë metra a më tepër të lartë. Dora e natyrës i kish radhuar me një bukuri të madhe. Ishin me të vërtet monumente të gjallë. Dyke ecur, më të mëngjër kemi patur Munellën e lartër si një nuskë me dullak të bardhë, edhe më të djathtë shkëmbinjtë si thikë të Malit Shenjtë, dhe të mbushur me pishë edhe me dborë. Të vinte keq të shkonje në vënde të ndryshme të kishin prerë këta shelgie të gjatë për një kapricje. T' i përdornin do t' ish mirë, mirëpo fatkeqësisht i kishim hedhur andej këtej dhe shumica e tyre qe kalbur. Pas një udhëtimit të gjatë zbritmë ke vau i Fanit Vogël.

Prej vaut kaluam shkallën e Bërzhanës dhe pastaj dualim në grykën e Bërzhanës, e